



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 1030/prot.
1

Tiranë, më 24.10.2024

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin e brendshëm për pozicionin e lirë të punës “Solist i Tretë Lirik (tenor)” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Audicioni do të zhvillohet në datën 2.12.2024, ora 14:00, në Hollin e Katit të Dytë të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Të gjithë ata artistë të brendshëm të interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Protokollit ose të skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al, deri në datën 25.11.2024, një letër shprehje interesi për pozicionin e lirë të punës.

Programi:

***Programi për konkurimin është interpretimi i roleve të plota (përzgjedhja e roleve për interpretimin nga kandidatët do të bëhet Komisioni i Vlerësimit) nga veprat e mëposhtme:**

1. W.A.Mozart: “The Magic Flute” - Roli: Tamino
2. G.Puccini: “Gianni Schicchi” - Roli: Rinuccio
3. G.Donizetti: “L’elisir d’amore” - Roli Nemorino

4. G. Donizetti: “Lucia di Lammermoor”- Roli: Arturo
5. G. Rossini: “Il Barbiere di Siviglia” - Roli: Il Conte di Almaviva
6. G. Rossini: “Stabat Mater”
7. W.A.Mozart: “Requiem”
8. G. Rossini: “La Cenerentola” - Roli: Don Ramiro
9. P. Jakova: “Mrika” - Roli: Doda
10. W.A.Mozart: “Don Giovanni” - Roli: Don Ottavio

Shënime:

1. Komisioni ruan të drejtën të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.
2. Nëse aplikantët nuk do të kenë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor do të mundësojë një shoqërues në piano në ditën e audicionit pasi të jetë lajmëruar paraprakisht nga aplikanti në momentin e depozitimit të letrës së shprehjes së interesit.
3. Aplikantët do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentit të kërkuar për pozicionin e punës.

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën e postës elektronike: sekretaria@tkob.gov.al.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Abigeila Voshtina

